

Mbledhjet publike

Mbledhjet e Këshillit të Qytetit, Komitetit të Shkollave dhe të Komisionit dhe Bordeve të Qytetit të Usterit në përgjithësi janë të gjitha të hapura për publikun dhe individët e interesuar inkurajohen që të marrin pjesë në to.

Mbledhjet publike i nënshtrohen ligjeve të Prokurorit të Përgjithshëm të Masaçusetsit për mbledhjet e hapura.

Të gjitha njoftimet dhe rendet e ditës të mbledhjeve publike publikohen në faqen e internetit të Qytetit të paktën 48 orë para çdo mbledhjeje. Rendet e ditës përvijojnë temat që do të diskutojë çdo bord. Afishohet gjithashtu procesverbal i të gjitha mbledhjeve të mëparshme për të informuar publikun në lidhje me frekuentimin, temat e diskutuara dhe votat e hedhura.

Për të siguruar mbledhje me rregull, bordet ndjekin **procedurat parlamentare** të cilat i referohen rregullave, etikës dhe praktikave që qeverisin mbledhjet dhe operacione të tjera të këtyre bordeve.

Këto rregulla përvijojnë procedura për t'u siguruar që të gjithë anëtarët e bordit ndjekin të njëjtat rregulla të shqyrtimit të hollësishëm, debatit dhe votimit.

Është thelbësore që të gjithë anëtarët të përfshihen dhe të kenë mundësinë të kontribuojnë në procesin demokratik të mbledhjeve. Këto rregulla janë vendosur që të inkurajojnë, jo të kufizojnë, pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve dhe të publikut.

Burimet

<http://www.mass.gov/ago/openmeeting>

<http://www.robertsrules.org>

Këshilli i Qytetit

**Takohet të martave në orën 6:30 PM *
Dhoma e Këshillit, kati i tretë i Bashkisë së Qytetit**

Usteri qeveriset nga një formë qeverisjeje me menaxher të këshillit dhe me kryetar bashkie të zgjedhur me votë popullore. Këshilli i qytetit vepron si organ legjislativ dhe menaxher i emëruar nga këshilli kryen funksionet ekzekutive të larta tradicionale të përditshme.

*Mbledhjet e korrikut dhe gushtit fillojnë në orën 6:00 pasdite.

<http://www.worcesterma.gov/city-council>

Komiteti i Shkollave

Takohet të enjten e parë dhe të tretë në orën 7:00 pasdite; dhoma e këshillit, kati i tretë i Bashkisë së Qytetit

Komiteti i Shkollave të Usterit është organi legjislativ dhe i bërjes së politikave që merret me mbikëqyrjen e Sistemit të Shkollave Publike të Usterit. Komiteti i shkollave zgjedh dhe pushon nga puna mbikëqyrësin e shkollave, aprovon buxhetet e arsimit publik në rajon dhe vendos politika arsimore dhe synime për çdo shkollë në rajon në përputhje me ligjet, synimet dhe standardet e vendosura nga

Bordi i Arsimit i Masaçusetsit.

<http://www.worcesterma.gov/city-clerk/public-meetings/agendas-minutes>

Qyteti i Usterit

Bordet dhe Komisionet

Banorët e Usterit shërbejnë si vullnetarë në tridhjetë borde, komisione dhe komitete këshillimore bashkiake. Vendndodhja, ditët dhe orët e mbledhjeve ndryshojnë; kontrolloni kalendarin e qytetit në internet ose te

<http://www.worcesterma.gov/boards-commissions>

Jeni i interesuar të shërbeni në një bord?

Kontakti:

michelsonj@worcestermagov

Për më tepër informacion dhe që të mësoni se si të bëheni anëtar i një bordi apo komiteti, kontakti: Jeannie Michelson me telefon (508) 799-1175 ose email: michelsonj@worcestermagov



MBLEDHJE E HAPUR * MIRËPRITET PUBLIKU


Udhëzues për pjesëmarrjen në mbledhjet publike



Qyteti i Usterit është i përkushtuar ndaj parimeve të mundësive të barabarta dhe veprimit gjithëpërfshirës.

*Botuar nga Zyra e Qasjes dhe Të Drejtave të Njeriut të Qytetit të Usterit
Përditësuar në prill 2021*

Qyteti i Usterit mirëpret pjesëmarrjen tuaj



Çfarë është mbledhja publike?

Një mbledhje e çfarëdo bordi, komiteti ose këshilli me disa anëtarë, të njohur si organ publik që është themeluar me qëllim shërbimin ndaj publikut, përbën një mbledhje publike.

Kush mund të marrë pjesë?

Mbledhjet publike janë falas dhe të hapura për publikun e përgjithshëm. Mirëprehen të rriturit dhe fëmijët. Jeni të lirë të shkoni dhe të vini sipas dëshirës.

Pse të merrni pjesë?

Duke marrë pjesë në mbledhjet publike, mund të informoheni për çështje të ndryshme në qytet si dhe të bëni komente për problemet ose zgjidhjet.

Si do ta di se çfarë po ndodh?

Ligjet që qeverisin mbledhjet publike kërkojnë që të afishohet publikisht 48 orë më parë një rend dite i cili përvijon atë çka do të diskutohet. Kopje të printuara të rendit të ditës janë gjithashtu në dispozicion të publikut gjatë mbledhjeve.

A mund të bëj pyetje ose komente?

Në përgjithësi gjatë mbledhjes ofrohet një periudhë kohe për komente nga publiku. E inkurajojmë publikun që të regjistrohet nëpërmjet stafit tonë. Kur t'i thirret emri nga kryetari për të folur, anëtari i publikut duhet të fillojë duke deklaruar emrin e tij dhe qytetin/qytezën e banimit dhe të referojë se cilën pikë të rendit të ditës dëshiron të shqyrtojë.

Po në qoftë se kam nevojë për nevoja të arsyeshme?

Qyteti i Usterit nuk diskriminon në bazë të paaftësisë. Të gjitha seancat dëgjimore dhe mbledhjet publike të sponsorizuara nga qyteti duhen mbajtur në vende të cilat mund të qasen nga njerëzit me paaftësi, duke përfshirë njerëzit që përdorin karrocet e invalidit.

Shërbimet dhe asistenca ndihmëse, materiale të shkruara në formate alternative dhe modifikime të arsyeshme në politika dhe procedura janë në dispozicion të personave me paaftësi me anë të kërkesës paraprake. Ju lutemi kontaktoni stafin ose ndërmjetësin e bordit.

A ka në dispozicion shërbime përkthimi për të më ndihmuar mua ose të tjerët që të marrin pjesë në mbledhje?

Po. Kontaktoni stafin ose ndërmjetësin e bordit jo më pak se 48 orë para mbledhjes për të bërë kërkesë.

A transmetohen në televizion mbledhjet?

Mbledhjet e Këshillit të Qytetit dhe Komitetit të Shkollave transmetohen drejtpërdrejtë dhe mbledhje të komisioneve dhe bordeve të tjera filmohen që të transmetohen më vonë në internet dhe në kanalën qasës të qeverisë.

A më lejohet që ta inçizoj ose filmoj mbledhjen publike?

Po. Njoftoni stafin ose ndërmjetësin e bordit se po bëni një regjistrim me zë ose me video dhe gjeni vendin më të mirë për të vendosur pajisjet tuaja me qëllim që të mos e ndërprisni mbledhjen ose të bllokoni pamjen e të tjerëve.

A e dini se niveli i qeverisë që ndikon më shumë te ju çdo ditë është qeveria lokale?

Qeveria lokale është përgjegjëse për parqet, bibliotekat, shkollat publike, rrugët dhe trotuarët publikë, regjistrimet e votuesve dhe pikat e votimit, licensat e bizneseve, zonimin tregtar dhe të banimit, dhënien e lejeve të ndërtimit, duke u siguruar se ka një numër të mjaftueshëm policësh dhe zjarrfikësisht në detyrë që të përgjigjen kur të keni nevojë për ta e shumë të tjera.

Rëndësia e një procesi pjesëmarrës në një vend demokratik

Pjesëmarrja në mbledhjet publike është një mënyrë nëpërmjet së cilës ju dëgjohej fjala. A e dini se kush janë përfaqësuesit tuaj lokalë të ngarkuar me bërjen e këtyre rekomandimeve dhe marrjen e vendimeve? A e dinë ata se çfarë doni ju dhe për çfarë keni nevojë nga Qyteti juaj?

Sugjerime për mbështetjen e çështjes tuaj

Pjesëmarrja në mbledhje publike ndihmon që të jeni i informuar për çështjet dhe është një forum ku mund të shprehni komentet dhe sugjerimet tuaja. Sigurohuni që të rishikoni përshkrimin e bordit dhe procesverbalin e mbledhjeve të kaluara që të jeni i informuar për çështjen si dhe për juridiksionin dhe/ose autoritetin e secilit bord për vendimin që kërkon.

Pika ndihmëse:

- Bëni punë kërkimore - grumbulloni informacion i cili forcon pikëpamjen tuaj
- Vlerësoni nëse ka mbështetje ose kundërshtim në komunitet
- Shkruajeni pikëpamjen tuaj dhe mbështeteni atë me referenca
- Flisni me zë të lartë, qartë dhe me respekt për të gjithë.